



ISBN -978-9951-Kosovë

NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT
INTERNATIONAL STANDARD BOOK NUMBER

Integrimi në sistemin e ISBN-së

ISBN - 978-9951-Kosovë

**BIBLIOTEKA
KOMBËTARE
DHE UNIVERSITARE
E KOSOVËS**



**THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVA**

Prishtinë 2007

Hyrje

Sistemi i ISBN-së në nivel ndërkombëtar ka filluar të funksionojë në fillim të vitit 1970. Ky sistem është zhvilluar dhe vijon të zhvillohet, të ruhet dhe të koordinohet vite me radhë nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së. Selia e Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së për disa dekada ka qenë e vendosur në Berlin. Nga viti 2006 kjo agjenci ka ndërruar vend dhe është vendosur në Londër. Tani rreth 160 vende të botës janë të integruara në mënyrë aktive në sistemin e ISBN-së, mes tyre vendeve, që nga viti 2001, gjendet edhe Kosova.

ISBN (International Standard Book Number) është sistem unik numërimi, identifikues për titujt sipas botuesit dhe vendit të botimit.

Rëndësia dhe roli i tij janë:

- Të identifikojë në mënyrë unike titujt;
- Duke u integruar lehtë në kompjuter, të ndihmojë në shkëmbimin e të dhënave;
- Të bëjë të mundshme porosinë dhe shpërndarjen e shpejtë dhe pa gabime të titujve.

Sistemi i ISBN-së u zhvillua në kohën kur kompjuterët u bënë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm në botë. Një numër i tillë ndërkombëtar ishte zgjidhje ideale në kohën e kompjuterizimit. Kështu, për nevoja të ndryshme në procesin e qarkullimit të librit, në vend që të bëhen përshkrime të gjata bibliografike, është i mjaftueshëm numri me vetëm disa shifra.

Zyra e ISBN-së për Kosovë

Zyra e ISBN-së për Kosovë ka filluar punën në vitin 2001, në kohën kur Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së, atëherë me seli në Berlin, ndau identifikuesin për Kosovën (9951), i cili ende është në përdorim, dhe që nga atëherë është pjesë e strukturës së shërbimeve të BKUK-së. Pas pesë vitesh, ende janë në funksion të gjitha seritë (radhët) e identifikuesve për botues sipas të cilëve është bërë grupimi i botuesve të Kosovës. Kur Agjencia përpiloi raportin e parë vjetor (2001-2002), kishte përafërsisht 150 ISBN të dhënë, për totalin prej 64 botuesve që u ishte ndarë identifikuesi për botuesin.

Në tetor të vitit 2006, numri i botuesve që kanë kërkuar dhe u është ndarë identifikuesi, është rritur në 307 (përfshirë këtu edhe autorët botues). Siç tregojnë këto statistika, numri i botuesve, autorëve, institucioneve etj., përgjegjës për botimin e librave, tani është shumëfishuar.

Kjo rritje e botimeve është pjesë e zhvillimit të hovshëm të veprimtarisë botuese në sektorin e librit, posaçërisht gjatë dy viteve të fundit në vend, por, njëkohësisht, edhe si pasojë e rritjes së vazhdueshme të interesimit të botuesve për pajisjen e publikimeve të tyre me ISBN.

Zyra e ISBN-së për Kosovë është përgjegjëse për regjistrimin e ISBN-ve të të gjitha librave që botohen në Kosovë. Mbajtja e këtij regjistri ose katalogu të botimeve ka rëndësi të posaçme, sidomos për faktin se Zyra e ISBN-së për Kosovë, duke u bazuar në këtë regjister, po punon në realizimin e projektit për botimin e ISBN-ve të Kosovës bashkë me një përshkrim të shkurtër bibliografik. Ky projekt është në realizim e sipër dhe botimi që do të nxirret me përfundimin e këtij projekti, do ta zëvendësojë përkohësisht bibliografinë **kombëtare** të pasluftës për vendin tonë, e cila, fatkeqësisht, tash për tash nuk ekziston.

Zyra e ISBN-së për Kosovë përkrah në mënyrë të vazhdueshme botuesit e Kosovës për integrimin e tyre në sistemin e ISBN-së dhe pajisjen e botimeve të tyre me këtë numër.

Zyra e ISBN-së për Kosovë:

- Përkrah pjesëmarrjen në sistemin e ISBN-së në vend;

- Vendos marrëdhënie bashkëpunimi me botuesit;
- Alokon identifikuesit për botues dhe mban regjistrin e botuesve dhe identifikuesve të tyre;
- Informon botuesit për implementimin e sistemit në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme;
- Siguron materiale dhe burime të cilat ndihmojnë në implementimin korrekt të ISBN-së;
- Informon botuesit për gabimet në përdorimin e ISBN-së;
- Mban relacione me Agjencinë Ndërkombëtare të ISBN-së në interes të botuesve të vendit;
- Raporton rregullisht pranë Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së.

Përfitimet nga përdorimi i ISBN-së

Sistemi i ISBN shërben si element kyç i porosisë, sistemit dhe inventarizimit të botimeve për botuesit, tregtuesit e librit dhe bibliotekat.

ISBN-ja është bazë për mbledhjen e të dhënave për botimet e reja të librave kudo në tregtinë e librit.

Përdorimi i ISBN-së gjithashtu lehtëson menaxhimin dhe monitorimin e të dhënave të shitjes në industrinë e librit.

Skemat e vjetra me shënime të shumta bibliografike, si: autori, titulli, viti botimit, botuesi, vendi i botimit etj., të cilat kërkojnë kohë dhe mund për t'u bërë, mund të zëvendësohen lehtë vetëm me një numër prej disa shifrash siç është ISBN.

Në shumë vende të botës bibliotekat kombëtare kanë krijuar një hallkë të ngushtë bashkëpunimi mes ISBN-së dhe Ekzemplarit të detyruar; ISBN përdoret për të kontrolluar ekzemplarin e detyruar, si dhe për të siguruar regjistrimin bibliografik të plotë dhe në kohë të të gjitha botimeve.

Integrimi në sistemin e ISBN-së është i rëndësishëm për të gjitha institucionet dhe organizmat e ndryshëm që kanë të bëjnë me veprimtarinë botuese dhe librin.

Botuesit

Integrimi në sistemin e ISBN-së për botuesit ka rëndësi të veçantë.

ISBN, si identifikues unik, shërben për:

- Identifikimin e botimeve monografike nga dorëshkrimi deri te redaktimi, procesi i prodhimit dhe dalja në publik;
- Kontrollin e fondit të titujve;
- Porositjen dhe shpërndarjen e titujve;
- Monitorimin e të dhënave të shitjes dhe shpërndarjes së titujve.

Tregtuesit e librit

ISBN, si identifikues unik nga tregtuesit e librit, përdoret për:

- Porositjen dhe shpërndarjen e titujve;
- Mbajtjen e llogarive dhe faturimin;
- Kërkimet bibliografike;
- Menaxhimin e sistemit të shitjes.

Bibliotekat

Saktësia dhe puna efektive e shumicës së sistemeve të punës në bibliotekë varet nga përdorimi i ISBN-së.

ISBN, si identifikues unik, i shërben bibliotekës për:

- Porositjen e titujve;
- Katalogimin e titujve;
- Qarkullimin dhe huazimin e titujve;
- Bibliografinë kombëtare.

Struktura e ISBN-së

Nga janari i vitit 2007 është futur në përdorim ISBN 13-shifror, struktura e të cilit përbëhet nga pesë elemente:

- **Prefiksi 3-shifror** - EAN (European Article Number) “978”, i cili aktualisht prezanton industrinë e librit.
- **Identifikuesi i grupit** - alokohet nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së dhe mund të jetë disa llojesh, si: identifikues për vende, gjeografikë, për gjuhë etj.

P. sh.:

978-0- Britania e Madhe, Kanadaja, SHBA etj.

978-3- Gjermania

978-81- India

978-951- Finlanda

978-9951- Kosova

978-99927- Shqipëria

- **Identifikuesi i botuesit** - Elementi i tretë i ISBN-së identifikon botuesin dhe përbërja e tij varet nga parashikimi i numrit të botimeve që do të nxjerrë botuesi brenda një kohe të caktuar. Varësisht nga ky parashikim, identifikuesi i botuesit mund të jetë më i vogël ose anasjelltas.

P. sh. : 978-9951-13-

- **Identifikuesi i titullit** - Ky element identifikon një botim të veçantë të botuar nga një botues i veçantë. Përbërja e tij varet nga vetë botuesi. Botuesit me numër të madh botimesh të parashikuar do të përdorin identifikues titujsh më të mëdhenj dhe anasjelltas.

P. sh.: 978-9951-13-000- deri 978-9951-13-999-

Shifra e kontrollit - është elementi dhe shifra e fundit i ISBN-së 13-shifror. Shifra e kontrollit del si rezultat i një llogaritjeje të 12 shifrave të tjera dhe na siguron se ISBN është pa gabime.

P. sh.: 978-9951-13-023-3

Aplikimi i ISBN-së

Teksti në vazhdim (nga 1. deri te 14.) është shkëputur nga Manuali i ISBN-së, dhe përmban rregullat për pajisjen e materialeve me ISBN.

1. Në përgjithësi

Një ISBN i veçantë mund t'i jepet çdo titulli të veçantë ose botimi të veçantë të një titulli.

Një ISBN i veçantë duhet t'i jepet botimit për secilën gjuhë, kur ai del në disa gjuhë të ndryshme.

Një titulli, që i dedikohet publikut si botim i veçantë, por edhe si pjesë e serisë, duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë dhe secili prej botimeve duhet të marrë ISBN të veçantë.

2. Ndryshimet në botime

Një ISBN i veçantë duhet t'i jepet botimit që ka pësuar ndryshime përmbajtjesore.

Një ISBN i veçantë duhet t'i jepet botimit që ka pësuar ndryshime në titull. Ndryshimet në dizajnin dhe ngjyrën e kopertinës ose në çmimin e botimit, nuk kërkojnë ISBN të veçantë.

Ndryshimet shumë të vogla (p.sh. korrektimi i gabimeve të shtypit) nuk kërkojnë ISBN të veçantë.

3. Rishtypja (riprodhimi)

Një ISBN i veçantë i jepet botimit të rishtypur, kur rishtypet nga tjetër botues ose ribotohet nën logon e një botuesi tjetër.

Një ISBN i veçantë i jepet gjithashtu titullit që është botuar nën logo të ndryshme nga i njëjti botues (kur botuesi ndryshon logon).

4. Librat në formate të ndryshme

Një ISBN i veçantë i jepet një titulli të publikuar në formate të ndryshme: p.sh. botimi në kopertina të forta, të buta, në brail, botime elektronike online etj., kërkojnë ISBN të veçantë. Kur botimet elektronike përgatiten në formate të ndryshme (p.sh. pdf, .html) secili prej tyre në mënyrë të veçantë merr ISBN-në e vet.

5. Publikimet me fletë të pangjitura (broshurat)

Një ISBN i veçantë i jepet botimit të përfunduar me fletë të pangjitura (broshurës) - pra një botimi me fletë të pangjitura (broshurë) që nuk mendohet të vazhdojë pakufi.

6. Veprat shumëvëllimëshe

Një numër i veçantë i jepet gjithë kompletit të vëllimeve të veprës shumëvëllimëshe; gjithashtu, secili vëllim merr numrin e vet të ISBN-së nëse qarkullojnë si të vetme. Kështu, bëhet i mundur procesimi dhe qarkullimi veç e veç i secilit vëllim. Bile edhe kur veprat shumëvëllimëshe mund të përdoren vetëm në komplet, dhënia e një ISBN-je secilit vëllim është i rekomanduar. Kjo ndihmon shumë gjatë lëvizjes së vëllimeve, si dhe në procesin e shpërndarjes, kur jo të gjitha vëllimet janë botuar dhe shpërndarë në të njëjtën kohë.

7. Lista e botimeve - Katalogu i botimeve

Botuesi ka nevojë të numërojë të gjitha listat e publikimeve dhe t'i botojë ISBN-të në ndonjë katalog që nxjerr botuesi qoftë në formë të printuar, qoftë në formë elektronike. ISBN duhet t'i jepet gjithashtu katalogut që lëshohet në përdorim.

8. Publikimet e përbashkëta (në bashkëpunim)

Një botim i cili nxirret si co-edition (botim në bashkëpunim me botues e tjerë) zakonisht merr ISBN nga botuesi që ka marrë përgjegjësinë e shpërndarjes. Botuesit e tjerë mund t'i vendosin atij nga një ISBN, nëse ata dëshirojnë. Në këto raste vetëm njëri prej këtyre ISBN-ve do të shfaqet (përdoret) si barkod.

9. Shitja ose shpërndarja e librave nga agjentët

(Përveç pikave a. dhe c. Kjo vlen vetëm për vendet që nuk janë ende anëtare të sistemit)

a) Sipas standardeve të ISBN-së, botimeve të veçanta, të botuara nga botues të veçantë, u jepet vetëm një ISBN. Ky ISBN nuk duhet të ketë përmbajtje se ku ose nga kush është shpërndarë ose shitur libri.

b) Një botim i importuar nga një distributor ekskluziv ose agjent shitës, nga një territor i cili nuk është në sistemin e ISBN-së dhe të cilit botim nuk i është dhënë ISBN, mund t'i jepet një ISBN nga distributori ekskluziv.

c) Botimet e importuar nga një distributor ekskluziv ose agjent shitës, te të cilët në faqen e titullit del logoja e distributorit ekskluziv, krahas logos së botuesit origjinal, marrin një ISBN të ri nga distributori ekskluziv ose agjenti shitës. Gjithashtu, duhet t'i jepet ISBN i botuesit origjinal.

d) Botimi që importohet nga disa distributorë nga një territor i cili nuk është i përfshirë në sistemin e ISBN-së dhe të cilit botim nuk i është dhënë ISBN, ndoshta mund t'i jepet një ISBN nga një grup Agjencish përgjegjëse për këta distributorë.

10. Pasurimi (pajisja) i një botuesi nga një tjetër

Botues që pajiset (pasurohet) nga një botues tjetër duhet të vazhdojë të përdorë ISBN-në origjinale

11. Pasurimi (pajisja) me komplet fondin e një botuesi

Një botues që pasurohet me komplet fondin e një botuesi tjetër duhet të përdori ISBN-në e botuesit origjinal, derisa kompania (botuesi) i ri të mos bëjë ribotimin nën emrin (logon) e tij.

12. Botuesit me më shumë se një vend botimi

- a. Botuesi që funksionon në disa vende, të cilët figurojnë së bashku në materialin e botuar (libër), do të marrin vetëm një ISBN për atë libër.
- b. Botuesi që funksionon me zyra ose filial të ndara në vende të ndryshme, mund të ketë element regjistruar të ISBN-së për secilën zyrë ose filial. Kështu, secili libër mund të pajiset me vetëm një ISBN nga zyra që është përgjegjëse për botim.

13. Regjistrimi i ISBN-ve dhe të dhënat (elementet përshkruese) që i shoqërojnë

Është përgjegjësi (detyrë) e secilit botues të informojë grupin e agjencive ose organizatën përgjegjëse për shërbimin (mirëmbajtjen) e regjistrimit të titullit për ISBN-të të cilat janë ndarë për botimet në vijim. Kur botuesi nuk e merr këtë përgjegjësi, grupi i agjencive ose organizata përgjegjëse për shërbimin e regjistrimit të titullit është e autorizuar të mbajë (të ruajë) regjistrin e ISBN-së të këtij botuesi. Informacioni do të përfshijë disa të dhëna (elemente përshkruese) minimale për titujt, si: ISBN, formati (lloji i materialit), titulli, seria, botimi (për ribotimet), gjuha e tekstit, botuesi, data e botimit etj.

14. ISBN asnjëherë nuk mund të ripërdoret (rivihet)

Një ISBN i ndarë për një botim asnjëherë nuk mundë të rindahet për të identifikuar një tjetër botim. Nëse ISBN-ja origjinale zbulohet se është e ndarë gabimisht, duhet të fshihet nga lista e numrave të ndarë dhe nuk duhet t'i jepet ndonjë botimi tjetër. Regjistruesi duhet të raportojë për numrat e gabueshëm Agjencinë e vet të ISBN-së.

Disa shembuj të llojeve të publikimeve monografike që duhet të marrin ISBN, janë:

- Librat dhe broshurat në formë të printuar;
- Publikimet në Brail;
- Publikimet që nuk janë menduar nga botuesi të plotësohen me shënime rregullisht ose të vazhdojnë të pasurohen me të dhëna në mënyrë të pakufizuar;
- Artikujt individualë ose botimet e pjesshme të një burimi kontinual (por jo një burim kontinual si tërësi);
- Hartat;
- Filmat, diapozitivat dhe video regjistrimet edukative/arsimore;
- Librat në shirit, në CD, ose DVD (librat me zë);
- Botimet elektronike në internet ose të tjerat si: disketat, CD-ROM-et etj.;
- Softuerët edukativë / arsimorë;
- Publikimet e përziera (ku përbërja kryesore është teksti).

Procedura e aplikimit për ISBN

Botuesit duhet të aplikojnë në Zyrën e ISBN-së për t'u pajisur me identifikuesin për botues. Pas kësaj, ata për çdo botim të ri duhet të marrin identifikuesin e titullit së bashku me shifrën e kontrollit. Shërbimi është falas.

Të gjithë botuesit që duan të aplikojnë për t'u pajisur me identifikuesin e ISBN-së, duhet t'i drejtohen Zyrës së ISBN-së, për të plotësuar aplikacionin.

Botuesit duhet të dërgojnë pranë agjencisë çdo ndryshim të adresës së tyre, si dhe të emrit (logos) të tyre; duhet të mbajnë një regjistër për çdo ISBN të ndarë për botimet e tyre dhe të njoftojnë agjencinë për çdo ISBN të shtypur gabim.

Informacione të tjera rreth funksionimit të sistemit të ISBN-së për Kosovë, ndryshimeve në strukturën e ISBN-së dhe ndryshimeve në procedurat e dhënies së ISBN-së, botuesit mund të gjejnë në ueb-faqen e BKUK-së, ku do të gjejnë edhe aplikacionin për t'u pajisur me identifikuesin e botuesit.

Së shpejti nga zyra e ISBN-së do të bëhet përpilimi i një rregulloreje mbi bazë të së cilës do të funksionojë sistemi i ISBN-së për Kosovë. Kjo rregullore, që do të hartohet nga BKUK, do të miratohet nga Ministria (përgjegjëse) në përputhje me kushtet e dhënies së ISBN-së, të parashikuara nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së me seli në Londër. Në rregulloren e funksionimit të sistemit të ISBN-së për Kosovë, përcaktohen procedurat që do të ndiqen për ofrimin, dhënien dhe kontrollin e zbatimit të ISBN-së, si dhe kushtet që duhet të plotësojë botuesi për kërkimin, marrjen dhe vendosjen e ISBN-së. (Kjo rregullore do të ketë mbështetje ligjore - Ligji për veprimtarinë botuese dhe librin; neni 22. thotë: *Rregullorja e Agjencisë së Standardizimit të botimeve të Librit përcakton procedurat që ndjek botuesi për kërkimin, marrjen dhe aplikimin e ISBN-së.*

Informacion shtesë rreth funksionimit të sistemit ndërkombëtar të ISBN-së, ndryshimeve në strukturën e ISBN-së dhe nevojës për këtë ndryshim, mund të gjeni në burimet e dhëna më poshtë:

International ISBN Agency: (përfshirë edhe manualin e ISBN-së)

<http://www.isbn-international.org>

Information About EAN.UCC GTIN:

<http://www.ean-int.org/products.html>

Check Digit Calculator:

http://www.gs1.org/productssolutions/barcodes/support/check_digit_calculator.html#gtin

Frequently Asked Questions About Changes to the ISBN

<http://www.lac-bac.gc.ca/iso/tc46sc9/isbn.htm>

ISO/ISBN:

<http://www.nlc-bnc.ca/iso/tc46sc9/wg4.htm>

EDItEUR:

<http://www.editeur.org>

IFLA:

<http://www.ifla.org>

Si të kontaktohet Zyra e ISBN-së për Kosovë

Adresa:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Agjensia Kombëtare e ISBN-së

Sheshi "Hasan Prishtina"

10 000, Prishtinë

Tel: +381 38 212 424

Fax: +381 38 248 940

E-mail: sbashota@hotmail.com

lavdije69@hotmail.com

URL: <http://www.biblioteka-ks.org/>

